



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTJA
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESDENICA



Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Platforma CiviKos, **hapin procesin e votimit për një (1) anëtar të Këshillit për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut për fushën Avancim i të drejtave të njeriut.**

Votimi do të jetë i hapur nga data 7 - 13 prill 2022, ora 16:00.

Kandidatët e nominuar janë:

Besim Kodra	Nominuar nga: Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK
Erbolina Dinarama	Nominuar nga: OJQ “Shtëpia e Sigurtë” Gjakovë
Hiljmnijeta Apuk	Nominuar nga: Little People of Kosovo
Luljeta Demolli Muhaxhiri	Nominuar nga: Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Të gjitha OShC-të e regjistruara në Kosovë mund të votojnë për një kandidat të përfshirë në fletëvotim. Fletëvotimin mund ta shkarkoni këtu:

MËNYRAT E VOTIMIT

Votuesit mund të hedhin votën e tyre:

- Me e-mail: info@civikos.net;
- Postë të rregullt (Adresa: Platforma CiviKos - Rr. Bedri Pejani 7/A, Prishtinë);
- Në kuti të votimit në zyrat e Platforma CiviKos, Rr. Bedri Pejani 7/A, Prishtinë).

Në rastin e votimit me e-mail ose me postë të rregullt, organizata që voton duhet të dërgojë fletëvotimin e plotësuar dhe kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së (votat pa dokumente mbështetëse nuk merren parasysh).

Sekretariati i Platforma CiviKos do të ndërmarrë të gjitha masat që votat me email dhe postë të mbesin sekrete.

Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platforma CiviKos, që caktohet nga Drejtori Ekzekutiv i Platforma CiviKos. Pas përfundimit të afatit për votim, komisioni i Sekretariatit të Platforma CiviKos do të numërojë fletëvotimet.

Kandidati që merr më së shumti vota do të emërohet anëtar i Këshillit.

Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues i OShC-ve në Këshill do të përcaktohet me short në mes tyre.

NUMËRIMI I VOTAVE

Për të mbikëqyrur procesin e numërimit të votave, Platforma CiviKos do të ftojë në cilësinë e vëzhgueseve të gjitha OShC-të që kanë bërë nominime, rrjetet aktive të shoqërisë civile, përfaqësuesit e Departamentit për Regjistrim të OJQ-ve dhe përfaqësuesit e Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës.

TRANSPARENCA

Platforma CiviKos do të publikojë listën e të gjitha organizatave që kanë votuar.

Të drejtë vote kanë të gjitha OSHC-të e regjistruara në Kosovë, pavarësisht a janë anëtarë në Platforma Civikos apo jo.